



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**  
**DURRES**

<b>Numri i Çështjes</b>	71041-02824-11-2019	<b>Data e Regjistrimit</b>	11/4/2019
<b>Numri i Vendimit</b>	11-2019-6524	<b>Data e Vendimit</b>	12/4/2019

**VENDIM**  
**NE EMER TE REPUBLIKËS**

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRES E PERBERE NGA:**

**KRYESUES:** Besjana Garxenaj

**ANËTAR**

**SEKRETARE** Hoxha Olsa

**Objekti:** 1-Heqjen e masës se sekuestros se vendosur me vendimin e Prokurorisë se Rrethit Gjyqësor Durres me date 29.05.2006 per sekuestrimin e Dosjes Përmbartimore të ekzekutimit te vendimit nr.720 ,date 09.07.1999 prane Zyres Përmbartimore Durrës.  
2- Heqjen e mases se sekuestros së vendosur me vendimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durres me date 05.06.2006 per sekuestrimin e praktikes se regjistrimit te siperfaqes prej 476 m2 tokë në lagjen 13 Plazh, Dunes të regjistruar ne bazë të vendimit nr .720 ,date 09.07.1990 të \*\*\*\*\* se Rrethit Gjyqësor Durrës në pronësi te shtetases Fiqirete Musabelliu.

**Baza Ligjore :** Neni 208 e vijes,212/1 K.Pr.Penale.

**Përmbledhja e vendimit:**

**Gjykata, pasi bëri verifikimin e pranisë së palëve në gjykim ku kërkuesi i kërkoj gjykatës se heq dorë nga gjykimi i çështjes,**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR  
DURRES

Vëren:

VËREN

I. Rrethanat e çështjes.

Pranë Gjykatës së Rrethit gjyqësor Durrës, në datë 01.11.2019 nga ana e kërkuesja \*\*\*\*\* , është paraqitur kërkesa me objektin e sipërpërshkruar.

Në seancën gjyqësore të planifikuar më datë 13.11.2019, në sekretarinë e gjykatës ishte depozituar dhe protokolluar me nr. 3551 dt. 13.11.2019, nga ana e kërkueses një kërkesë ku shpreh se heq dorë nga gjykimi i kësaj kërkesë. Ndodhur para një kërkesë të tillë, Gjykata duhet të procedojë sipas parashikimeve të nenit 471/5 të K.Pr.Penale në të cilin thuhet se: *“5. Kur kërkuesi nuk paraqitet në seancë pa ndonjë shkak të arsyeshëm, megjithëse ka dijeni rregullisht për datën dhe orën e saj, heq dorë nga kërkesa, ose ndryshon objektin e saj, gjykata e deklaron atë të papranueshme”*. Duke qenë se kjo dispozitë ka parashikuar vendimmarrjen e gjykatës në rastin kur kërkuesi heq dorë nga kërkesa, atëherë kjo e fundit duhet të deklarohet e papranueshme. Është në vullnetin e kërkueses që të vijojë ose jo gjykimin e kërkesës së saj, e cila në këtë rast hoqi dorë.

Për keto arsye:

Baza Ligjore:

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar në nenin 471/5 të Kodit të Procedurës Penale,



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**  
**DURRES**

Vendosi:

1. Deklarimin e papranueshëm të kërkesës penale me Nr. Regjistri Themeltar (71041-02824) 648, datë 04.11.2019, me kërkuese \*\*\*\*\*  
\*\*\*\*\* , me objekt: *“1-Heqjen e masës se sekuestros se vendosur me vendimin e Prokurorisë se Rrethit Gjyqësor Durrës me date 29.05.2006 për sekuestrimin e Dosjes Përmbareme të ekzekutimit te vendimit nr.720 ,date 09.07.1999 pranë Zyrës Përmbareme Durrës. 2 - Heqjen e masës se sekuestros së vendosur me vendimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës me date 05.06.2006 për sekuestrimin e praktikes se regjistrimit të sipërfaqes prej 476 m2 tokë në lagjen 13 Plazh, Durrës të regjistruar ne bazë të vendimit nr .720 ,date 09.07.1990 të Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Durrës në pronësi te shtetases Fiqirete Musabelliu”, për shkak se kërkuesi hoqi dorë.*
2. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen kërkueses.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 15 ditëve nga dita e nesërmja e shpalljes së vendimit, në Gjykatën e Apelit Durrës.

**U shpall në Durrës, sot më 13.11.2019.**

Ky dokument është marrë nga [www.gjykata.gov.al](http://www.gjykata.gov.al). Ai ka vlerë të plotë informuese, por nuk shërben si dokument zyrtar. Ky i fundit lëshohet nga autoritetet përkatëse.